


CAT MAGAZINE



KËSHILLAT E OPERATORIT & PRAKTIKAT MË TË MIRA:

**AJO QË NUK DINI
KUSHTON PARA**

**NJË MINIERE DHE FSHAT NDAJNË
VLERA KOMUNITETI SHARE**

**MARRJA E MONITORIMIT TË GJENDJES NGA
TRILLIMI SHKENCOR NË FAKTIN SHKENCOR**

Teknoxgroup

CAT



MË PAK KOHË PA PUNË, JETË MË E GJATË, KOSTO MË TË ULËTA

ME SHËRBIMIN TË GJURMIMIT TË PËRSHTATJES CATERPILLAR

'ASNJË KOHË PA PUNË' PËR SHËRBIMET MJEDISORE TË EGJIPTIT

Shërbimet Mjedisore të Egjiptit janë të specializuara në trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve të ngurta. Shoqëria mbështetet nga një tregtar vendor i Cat Mantrac me një kontratë totale të riparimit për të gjitha makineritë si pjesë e kërkesës së tyre për "Asnjë Kohë pa Punë".

Kryerja e CTS ishte esenciale si pjesë e zgjidhjes. Me ndjekjen e vazhdueshme pas çdo 1,500 orës, rezultatet tregojnë që brenda dy muajsh dy makina – një traktor i tipit me zinxhir dhe një ngarkues i tipit me zinxhir – kishin nevojë për shërbim dhe zëvendësim të komponentëve poshtë shasisë. Për pasojë planifikimi në kohë eliminoi defektet potenciale, duke parandaluar ndërprerjen e panevojshme në kantiere.

Thotë Ahmed Soliman Sorour, i cili ka qenë me Mantrac që prej Gushtit 2009 dhe tani kryhen inspektime CTS: "CTS ka hapur mundësi të reja për klientët dhe ka ritur kredibilitetin tonë tek ta. Sot ne kryejnë një mesatare prej 50 inspektime CTS në muaj me rreth 15 klientë."

Caterpillar ndërton vlerë dhe qëndrueshmëri në çdo sistem shasisë duke balancuar faktorët kritikë të tillë si lëndët e para, proceset e trajtimit të nxehtësisë dhe sasinë e materialeve të konsumueshme. Dhe sigurisht ju doni të reduktoni kohën pa punë dhe të planifikoni mirëmbajtjen e shasisë në mënyrë që të reduktohen kostot sa më shumë që të jetë e mundur. Programi i inspektimit të Shërbimit të Gjurmimit të Përshtatjes së Caterpillar (CTS) është zhvilluar për të ndihmuar që ju të arrini këto qëllime.

RRITJA E VLERËS SË NDËRTUAR BRENDA MAKINERISË

Komponentët e shasisë konsumohen sipas kushteve dhe teknikeve të operimit dhe për këtë arsye mund të menaxhohen si një sistem. Duke siguruar menaxhimin e specializuar të sistemit dhe asistencën e planifikimit, inspektimi i Shërbimit të Gjurmimit të Përshtatjes të Caterpillar ju lejon të përfitonit plotësisht nga kjo vlerë e ndërtuar brenda makinerisë.

Shërbimi punon me ju për të monitoruar performancën dhe për të parashikuar ritmet e konsumimit, duke ju ndihmuar që të planifikoni mirëmbajtjen dhe të vlerësoni opsionet tuaja më ekonomike të mirëmbajtjes. rezultati? Do të jeni në gjendje që të programoni shërbimin në vend që të ndërprisni punën në mënyrë të pa programuar dhe me kosto.

ANALIZA E SHPEJTË, E SAKTË

Për të marrë vendimet më të mira për shasinë, ju duhet informacioni i saktë, dhe që t'ju jepet kur t'ju nevojitet. Përdorimi i pajisjeve më të avancuara të diagnostikueshme në dispozicion, të tilla si indikatorët, ultratinguj të konsumimit, inspektimi i Shërbimit të Gjurmimit të Përshtatjes

do të monitorojnë saktë performancën gjithmonë dhe do të parashikojnë ritmin e konsumimit.

Matjet merren nga pozicione të ndryshme përreth shasisë duke përfshirë lidhjet, afolio, ferrotat, pinjonët dhe rulat.

VENDIME TË INFORMUARA PËR PRODUKTIVITET MË TË LARTË

Informacioni i mbledhur nga matjet e shasisë analizohen dhe përdoren për të përpiluar raporte gjithëpërfshirëse. Këto ju japin një vëzhgim praktik për kushtet aktuale të shasisë dhe jetën e parashikuar të komponentëve të saj të ndryshëm. Kështu ju vlerësoni opsionet e shërbimit, planifikoni mirëmbajtjen tuaj dhe planifikoni kohën pa punë.

Shkurt, inspektimi i Shërbimit të Gjurmimit të Përshtatjes të Caterpillar ju garanton të gjithë informacionin që ju nevojitet për të marrë vendime të informuara që do t'ju ndihmojnë për t'i mbajtur makineritë tuaja në punë me rendimentin optimal ndërsa reduktoni kostot sa më shumë që të jetë e mundur. ■





Mësoni për marrëdhënien unike midis një miniere dhe fshatit fqinj në Chelopech, Bullgari.



Ne shikojmë tre vende të suksesshme landfilli ku gazi konvertohet me energjinë e kompleteve të gjeneratorëve.



Për vende pune më të mëdha dhe qëndrueshmërinë e pajisjeve, këto këshilla për operatorin bëjnë një dallim të madh.



Ekskluzivisht nga Caterpillar®, gomat novatore Flexport™ marrin një formë tërësisht të re.

I dashur lexues,

Qëndrueshmëria është një temë e nxehtë në të gjithë globin. Tek Caterpillar, ne e shikojmë atë si një mundësi për të pasur një ndikim pozitiv në rezultatet tona përfundimtare dhe në botën në të cilën jetojmë. Dhe, falë linjës sonë ekstensive të produkteve, përpjekjet tona kanë ndikime shumë të mëdha në fusha të tilla si energjia, infrastruktura, ndërtimi, minierat dhe marina.



Ne përpiqemi gjithashtu që të sigurojmë mjedise pune, produkte, shërbime dhe zgjidhje që përdorin në mënyrë eficiente burimet natyrore të botës dhe reduktojnë ndikimet dëmtoese në planet. Në këtë numër, do të gjeni artikuj që fokusohen në mënyrat e shumta me të cilat po ndihmojmë klientët tanë që të punojnë në mënyrë më të qëndrueshme.

Për shembull, ju do të lexoni për atë se si novacionet e Caterpillar po krijojnë kursime të rëndësishme karburanti pa sakrifikuar fuqinë e makinës dhe se si lëngu hidraulik i biodegradueshëm të përdoret për të ndihmuar në mbrojtjen e zonave të ndjeshme mjedisore. Kur vjen fjala tek energjia, do të mësoni se si kompletet e gjeneratorëve Cat ndihmojnë për të kthyer gazin e landfillëve në energji elektrike. Kemi përfshirë gjithashtu një histori intriguese për atë se si një minierë në Chelopech, Bullgari po e çon përgjegjësinë shoqërore dhe mjedisore në një nivel tjetër.

Duke theksuar krijimin e komuniteteve të shëndosha, ne përpiqemi gjithmonë që të ecim përpara. Jemi të angazhuar të përmirësojmë në mënyrë konstante produktet dhe shërbimet tona me qëllimet e minimizimit ose eliminimit të mbetjeve dhe ndikimeve mjedisore. Është tepër e rëndësishme që ta mbajmë fokusin tonë fort në këto përpjekje. Ato jo vetëm që rritin konkurrueshmërinë, por gjithashtu kontribuojnë në qëndrueshmërinë tonë.

Sistemet e prodhuara nga njeriu të shoqëruara me menaxhimin e energjisë, materialeve, ujit dhe tokës kanë një impakt mjedisor. Së bashku, megjithatë, ne mund ta minimizojmë atë impakt duke maksimizuar eficientë dhe duke punuar për të krijuar një botë vërtetë të qëndrueshme.

Paolo Fellin,
Zëvendës President i Caterpillar

NJË SHOQËRI MINERARE MODEL QË ËSHTË EDHE NJË QYTETAR MODEL

Si ndihmoi gërmimi për ar dhe bakër që të ndërtohej një fshat

4

KONVERTIMI I MBETJEVE NË ENERGJI, NJË VIZION I BREZAVE TË ARDHSHËM

Energjia e tre landfillëve jep energji për komunitetet

9

TË FLASIM PËR TË ARDHMEN E SHËNDETIT TË PAJISJEVE, SOT

Ky tregtar Cat e njej gjendjen e pajisjes tuaj përpara se ta njihni ju

12

AFTËSITË E MPREHTA JAPIN EFICENCË DHE KURSIME

Këshilla operatorit nga Emmanuel "Skinny" Chatelain

14

PRODUKTIVITETI I KANTIERIT TË PUNËS RRIETET GJITHNJË E MË TEPËR

Një marifet i zgjuar me gomat solide

16

ANKETIM I LEXUESIT

Duam të dimë se çfarë mendoni ju

17

Sa më sipër, është thjesht një shije e asaj se çfarë përmban ky numër i revistës – do të gjeni shumë më tepër lajme dhe pikëpamje brenda tij. Në qoftë se keni ndonjë ide për një histori për numrin e ardhshëm, kontaktoni botuesit tanë në CatMagazine@cat.com

BOTUESI: Ulrike Schwarzenzahl, Caterpillar S.A.R.L. **KRYEREDAKTORI:** Laetitia Baudrion, Caterpillar S.A.R.L. **KORDINIMI I TREGTARËVE:** Anneloes de Jong **SHKRUESI KRYESOR:** Trevor Baker **DREJTIMI I ARTIT:** Ron Strik **FOTOGRAFIA:** Peter Verver **KONCEPTI & REALIZIMI:** Centigrade për Caterpillar S.A.R.L. www.centigrade.com **KONTAKTI VENDOR I TREGTARËVE:** info@teknogroup.com

Revista Cat shpërndahet nga tregtarët e Caterpillar në Europë, Afrikë, Lindjen e Mesme dhe CIS tre herë në vit. Ju lutemi, dërgoni korrespondencën tuaj editoriale tek Revista Cat, Caterpillar S.A.R.L. 76, Route de Frontenex, PO Box 6000, 1211 Gjenevë 6, Zvicër. CatMagazine@cat.com. Të gjitha të drejtat e rezervuara. ©2011 Caterpillar.

NJË SHOQËRI MINERARE MODEL QË ËSHTË EDHE NJË QYTETAR MODEL

VENDNDODHJA:
CHELOPECH,
BULLGARI



Revista Cat kohët e fundit udhëtoi për në Chelopech, Bullgari për të mësuar jo vetëm se si makinat Cat po ndihmojnë operacionin minerar Chelopech, por edhe për marrëdhënien e ngushtë të krijuar midis minierës dhe komuniteteve përreth. Ajo që zbuluam ishte një shembull frymëzues i përgjegjësisë shoqërore dhe qëndrueshmërisë. Ju ftojmë të bashkoheni me ne në udhëtimet tona 70 kilometra nga kryeqyteti i Bullgarisë, Sofia, dhe në Malet e Ballkanit.

Në mëngjesin e vizitës sonë, kishte dalë dielli dhe po kështu edhe trafiku i orëve të nxitimit. Megjithatë, së shpejti ne po udhëtonim përgjatë një rruge gjarpëruese mjaft e lëmuar që na udhëzonte me anë të shtëpive të vjetra të botës, kullotave të blerta të gjera dhe pyjeve malorë me pisha të bukura.

Mbërritëm pak më shumë se një orë. Menjëherë, mund të dallonit se gërmimi në Chelopech është i ndryshëm. Këtu, njerëzit krenohen që kujdesen për fshatrat dhe komunitetet fqinje. Në fund të fundit, shumë prej 1,050 njerëzve që punojnë në minierë jetojnë me familjet e tyre në ato fshatra. Prandaj, të bësh çmos për të siguruar që çdo njeri të përparojë e begatojë, ka kuptim.

Pika jonë e parë e biznesit, megjithatë, ishte që të flisnim me Kryeinxhinierin Stoyko Peev. Në fakt ai përgjigjet për tonelata punë. Titulli i tij zyrtar, megjithatë, është Mbikëqyrësi i Mirëmbajtjes së Minierës. Pa humbur asnjë sekondë, ne u futëm deri në gju në operacionet e pajisjes Cat® dhe në detajet e mirëmbajtjes.

PSE ZGJODHËT PAJISJEN CAT?

Peev: "Kryesisht për shërbyeshmërinë e pajisjes. Së dyti, por jo më pak të rëndësishme, janë kushtet e punës

për operatorët. Makinat Cat kanë hapësirë të gjerë, ajër të kondicionuar dhe makinat janë të lehta për tu manovruar. Gjithashtu, në Bullgari ekziston një furnizim i mirë me pajisjet Cat. Nuk kemi problem për të marrë pjesët e këmbimit dhe tregtari ynë Eltrak është i mirë për sigurimin e trajnimit parandalues të mirëmbajtës."

ÇFARË LLOJ TRAJNIMI JEPET?

Peev: "Kemi një qendër trajnimi në terren dhe ajo kryen në mënyrë konstante trajnimin. Në radhë të parë mësojmë njerëzit si të përdorin pajisjet. Pastaj përqendrohemi tek mirëmbajtja."

Kryeinxhinieri Plamen Stoichev ishte gjithashtu në dhomë. Stoichev është Drejtori Ekzekutiv për Eltrak Bullgari dhe ofroi disa informacione me vlerë.

SI U PËRFSHI ELTRAK NË TRAJNIMIN E MAKINAVE CAT?

Stoichev: "Ne zhvilluam një program trajnimi pionier disa vite më parë. Filluam me një prezantim të pajisjes për një gjysëm dite dhe operacionet e sigurisë, pastaj 1 deri në 1.5 ditë trajnim në terren me operatorë të veçantë për të siguruar që ata e kishin kuptuar se si ta vinin në punë pajisjen në mënyrë të sigurt dhe produktive."

PO PËR MIRËMBAJTJEN?

Stoichev: "Ne u treguam njerëzve në Minierën në Chelopech se si të kryenin servisin e makinave të tyre. Kjo ishte mënyra për tu dhënë atyre maksimumin e kohës së përdorimit."

U dhamë atyre programe testimi dhe çdo gjë tjetër që nevojitej, dhe jo vetëm sepse donin të kursenin para. Një përfaqësues i Eltrak akoma na viziton çdo javë. Ky është një shembull i mirë i asaj se të dy palët mund të kenë

Stoyko Peev, Mbikëqyrësi i Mirëmbajtjes së Minierës.



përfitim. Tani këtë ne e bëjmë për çdo klient. Ky është programi më gjithëpërfshirës i trajnimit në Bullgari.”

NA THONI PËR NGARKUESIN ME RROTA 966K PËR GËRMIMET E CHELOPECH

Stoichev: “Kur u treguam atyre për herë të parë Cat 966K, Ivan Mihov, Mbikëqyrësi i Prodhimit së Fabrikës së Përpunimit, nuk ishte i sigurt nëse operatorët do ta mësonin ta përdornin atë. Por, falë trajnimit të duhur dhe natyrës intuitive të kontrolleve, tani ata nuk mund ta imagjinojnë përdorimin e ngarkuesit me rota përsëri me një timon.”

Duke pasur parasysh këtë, ne ishim të paduruar të shikonim në punë Cat 966K dhe të dëgjonim se çfarë do të thoshin operatorët. Ivani na çoi në makinë përgjatë rrethinave të fshatit Chelopech dhe në një rrugë me pisllek. Rreth një kilometër dhe një kontroll sigurie më vonë, arritëm në një pìrg ku 996K dhe një kamion i artikulluar Cat 725 ishin duke punuar për të ngarkuar dhe tërhiqnin copa të mëdha minerali duke kërkuar ar, bakër dhe metale të tjera të çmuara. Ivani na shpjegoi se çfarë po ndodhte.

Mihov: “Ky është pìrgu i mineralit që del nga nëntoka. Çdo makinë manipulon 100,000 ton mineral çdo muaj. 966K është i pari në rajon dhe motori i parë Stage IIIB me rigjenerim automatik. Është shumë më lehtë ta përdorësh atë. Kur përdorni një makinë me timon duhet të ngrihesh vazhdimisht lart. Përdorimi i dorezave është shumë më i mirë dhe ju bën më të relaksuar.”

Ndërsa Mihovi u kthye në punë, ne shkuam në fshat për të vizuar shkollën e gjuhës angleze të Minierës Chelopech, të cilën Miniera Chelopech e mbështet plotësisht.



Këtu ne kuptuam se sa e angazhuar ishte shoqëria për përgjegjësitë shoqërore dhe qëndrueshmërinë në zonë.

Mbërritëm në një oborr me hije i mbushur me fëmijë që luanin dhe një shkollë më e madhe se sa e prisnim. Brenda, dhe lart pas dy shkallësh, gjetëm një klasë plot me studentë dhe Drejtorin Nikolay Krustev në krye të klasës.

ÇFARË ËSHTË SHKOLLA E GJUHËS ANGLEZE E MINIERËS CHELOPECH?

Krustev: “Shkolla ka funksionuar që prej vitit 1995 dhe është e vetmja shkollë private që drejtohet nga shoqëria për gjuhën e huaj në Bullgari. Miniera Chelopech garanton fondet dhe meqenëse kjo është një shkollë private, kostoja për ta ndjekur atë është e ulët. Kemi rreth 115 studentë që shkojnë që nga moshja 14 deri në 19 ose nga klasa e 7 deri në klasën e 12.”

I vetmi 996K i Bullgarisë (që vihet në punë duke përdorur levat e kontrollit) gërmon në një pìrg në minierën Chelopech.

Plamen Stoichev, Drejtori Ekzekutiv, Eltrak Bullgari.





Nikolay Krustev, drejtori i shkollës së Gjuhës Angleze në Chelovech.

PSE E FINANCON SHKOLLËN MINIERA CHELOPECH?

Krustev: "Jam i mahnitur me atë që po bëjnë ata. Është shumë e pazakontë, por ata japin fonde sepse kujdesen vërtetë për komunitetin."

Mbaruam së foluri me Z. Krustev ndërsa nxënësit mbaruan mësimin për atë ditë. Ndërsa ata vraponin drejt dyerve, ne folëm me mësuesen e historisë Dimitrinka Arnaudova.

ÇFARË DALLIMI BËJNË KONTRIBUTET E MINIERËS CHELOPECH ?

Arnaudova: "Ata na mbështetin financiarisht kështu që ne nuk varemi nga buxheti i shtetit. Kjo bën një dallim të madh sepse nuk është e nevojshme që të kërkojmë ndihmë shtesë."

ÇFARË LËNDËSH MËSOHEN KËTU?

Arnaudova: "Ne jemi një shkollë e mesme gjuhësore. Vitin e parë studentët studiojnë kryesisht Anglisht. Gjatë vitit të dytë, ata studiojnë lëndë të ndryshme në Anglisht të tilla si historia, gjeografia dhe biologjia si dhe Gjermanisht dhe Spanjisht."

Shkolla ka një përqindje të habitshme suksesi gjithashtu. Aktualisht, 98 për qind e nxënësve të shkollës shkojnë në arsimin e lartë dhe 25 për qind studiojnë jashtë shtetit në vende të tilla si Shtetet e Bashkuara, Holanda, Franca dhe Italia.

Duke e lënë të qeshurën e fëmijëve të shkollës pas, destinacioni ynë i radhës ishte më paqësor – Kisha e Shën. Nikolay Mirlikiisky Çudibërësi. Ndërtuar në vitin 1835, kisha e vogël kishte ngelur tërësisht pa u riparuar. Edhe ikonostaset historike, të pikturuara në 1856, ishin mbuluar nga një shtresë e trashë boje kafe me bazë vaji.

Duke treguar përsëri mënyrën e tyre të hijshme, Miniera Chelovech mori përsipër që ta rinovojë këtë objekt të rëndësishëm të fshatit. Ne folëm me Antonii Marchev, prifti dhe kujdestari i kishës.

SI ISHTE GJENDJA E KISHËS PËRPARA RINOVIMIT?

Priest Marchev: "Kisha kishte nevojë për rindërtim rrënjësor. Çatia ishte në gjendje shumë të keqe, dhe kulla e kambanës po anohej kaq shumë sa që ishte e rrezikshme. Çdo gjë duhej të rindërtohej, duke përfshirë gardhin dhe oborrin."

SI NDIHENI TANI QË KISHA ËSHTË RESTAURUAR?

Priest Marchev: "Unë jam pjesë e këtij procesi megjithëse Miniera Chelovech i kreu të gjitha rinovimet. Është vështirë të rinovosh kishën sepse duhen shumë burime. Por është më e vështirë të restaurosh tempujt brenda zemrave të njerëzve."

SA KOHË MORRI RINOVIMI I ÇATISË, KULLËS SË KËMBANËS DHE FASADËS?

Priest Marchev: "Duke filluar në vitin 2008, riparimet u bënë me faza. Së pari, çatia u zëvendësua bashkë me restaurimin e fasadës duke u bërë siç ishte në fillim. Në vitin 2010, kulla e kambanës u rindërtua tërësisht."



Antonii Marchev, prifti dhe kujdestari i kishës.



Në pìrgun e mineralit, Ivani u bëri me shenjë operatorëve, Hristo Delov dhe Lyubomir Rakov, që të zbrisnin dhe të flisnin me ne për ngarkuesin me rrota 966K. Ai ishte i nxehtë, me pluhur dhe me zhurmë, por operatorët dukeshin se ishin si në shtëpi. Në fund të fundit ata kishin kabina të puthitura mirë dhe me ajër të kondicionuar.

SI JU DUKET CAT 966K?

Lyubomir: "Na pëlqejnë shumë levat e kontrollit. Nuk isha i sigurt nëse do të isha në gjendje që ta

E ardhmja e kishës megjithatë duket e mirë. Miniera Chelovech po ndihmon me rinovime shtesë duke përfshirë dyshemenë dhe përmirësimet e kopshtit, gardhi i oborrit të kishës dhe punimet restauruese që vazhdojnë për ikonostasin.

Nga kisha ishte një udhëtim i shkurtër për të takuar Christina Paneva dhe Nikola Berberov në fshatin Chelovech. Paneva, një specialist në pension i radio/telekomunikacionit dhe Berberov, një ekonomist në pension kishin kaluar shumicën e jetës së tyre në Chelovech. Ata kanë qenë dëshmitarë të ndryshimeve dhe transformimeve që Miniera Chelovech ka sjellë në zonë.

ÇFARË MENDONI PËR FQINJËT TUAJ?

Berberov: "Miniera jo vetëm që jep pagat, ajo jep bukë respekt për veten gjithashtu. Kjo është diçka që ne nuk duhet ta nënvlerësojmë."

Paneva: "Falë minierës, kemi një shkollë shumë të mirë, kopsht dhe klub pensionistësh. Të gjitha gjërat që miniera bën për komunitetin tonë ndihmojnë imazhin e fshatit tonë."



manovroja siç duhej. Por, dyshimet e mia u larguan shpejt. Levat e kontrolleve janë të lehta për tu përdorur dhe ka më pak peshë në bel dhe në shpinë kështu që njeriu mund të punojë më shpejt.”

Hristo: “Është më e lehtë ta manovrosh dhe kabina është shumë më e rehatshme. Sedilja është më e mirë. Thjesht nuk lodhesh. Mendoja se duhet të ndryshoja stilin tim sepse kalimi nga një timon tek levat do të ishte e vështirë por kjo ishte e lehtë.”

Operatorët Hristo Delov (majtas) dhe Lyubomir Rakov.



PSE MENDONI SE MINIERA CHELOPECH I JEP KËTO GJËRA?

Berberov: “Vullneti i mirë dhe dhembshuria është në natyrën e tyre. Ata nuk mund të bëjnë çdo gjë ose të plotësojnë çdo kërkesë por ata japin mjaft dhe ne mund tu japim vetëm falënderime shumë të mëdha.”

Paneva: “Shoqëria mbështet shëndetin e komunitetit duke organizuar kontrole mjekësore falas madje edhe një klub karateje. Ata përkrahin gjithashtu dy klube Koukeri duke blerë maskat dhe duke ndihmuar që klubet të marrin pjesë në festivale. Është një traditë e veçantë për Bullgarinë, veçanërisht në këtë zonë.”

SI KOMUNIKON MINIERA CHELOPECH ME FSHATIN?

Berberov: “Ata kanë përzgjedhur njerëzit që punojnë mirë me komunitetin. Ata janë të thjeshtë, që mund t’i takosh dhe të lehtë për t’i kontaktuar. Ata i kuptojnë nevojat e atyre që jetojnë në fshat dhe gjithmonë marrin mbështetjen dhe mirëkuptimin pavarësisht nëse është një ankesë apo thjesht shprehja e një falenderimi.”

Si Paneva edhe Berberov janë mirënjohëse për atë që bën Miniera Chelopech për ta dhe komunitetet përreth. Por ajo që ndoshta spikat për Christinën dhe Nikolan ishte sinqeriteti në zërat e tyre dhe vlerësimi që ata kanë për vendin ku jetojnë.

Intervista jonë e fundit e ditës ishte me Irena Stambolieva. Ajo është Drejtore e Shëndetit, Sigurisë, Mjedisit dhe Marrëdhënieve me Komunitetin për Minierën Chelopech dhe një ekip prej 50-personash jashtë shtetit.

PËRSE MINIERA CHELOPECH I NDIHMON KËTO KOMUNITETE VENDORE?

Stambolieva: “Ne, dhe fqinjët tanë të minierës, e dimë që jetëgjatësia e një miniere është e kufizuar. Pikërisht për këtë, ne ndjehemi të detyruar që ta shpërblejmë komunitetin. Ne duam që njerëzit të zhvillojnë aftësitë që ata mund të përdorin pasi të ketë mbaruar jetëgjatësia e minierës. Sigurimi i qëndrueshmërisë së kësaj zone është shumë e rëndësishme për ne.”



Christina Paneva, specialiste e radio/ telekomunikacioneve në pension, dhe Nikola Berberov, ekonomist në pension.



PËRSE E KONSIDERONI CHELOPECH UDHËHEQËS NË KËTË FUSHË?
Stambolieva: "Ne kemi programe shoqërore dhe mjedisore shumë të qëndrueshme. Mendoj se është një praktikë e mirë për tu treguar njerëzve se nuk mendojmë vetëm fitimet por edhe për mjedisin ku jetojnë njerëzit."

Praktikat tona i ndihmojnë studentët që të mësojnë aftësitë e vlefshme që mund t'i përdorin në të ardhmen. Kemi programe shumë të forta që drejtohen drejt arsimimit, kulturës, sporteve dhe infrastrukturës. Në fakt, ka mungesë fondesh për rindërtimin e rrugëve në Bullgari – veçanërisht në rrugët që janë pronë e bashkisë – kështu, ne i kushtojmë shumë burime rrugëve dhe infrastrukturës."

SI PËRFSHIHENI NË KËTO PROJEKTE TË NDRYSHME?

Stambolieva: "Ne duam të përfshihemi në projekte që do të kenë efekt pozitiv. Normalisht, ne i kërkojmë këshillave të bashkive që të na thonë çfarë është më e rëndësishme. Dhe në këtë mënyrë ne vendosim për të ndihmuar në infrastrukturë, në impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm dhe në restaurimin e kishës."

Ne gjithashtu e dimë se traditat janë shumë të rëndësishme. Fshatrat janë të vegjël, por ata i mbajnë gjallë traditat Bullgare. Ne duam që fëmijët të rriten duke mësuar folklorin vendor, të dinë se si visheshin gjyshërit e tyre dhe të mbajnë gjallë traditat për Pashkët dhe Krishtlindjet"

CILAT JANË DISA NGA PROJEKTET QË JU KENI PLANIFIKUAR PËR TË ARDHMEN?

Stambolieva: "Ne kemi dy projekte për të përmirësuar tubacionin e furnizimit me ujë në dy rrugë, të cilat gjithashtu do të shtrohen. Më tej do të rinovojmë"

Kishën e Shën Nikolajit duke i shtuar disa ndërtime të reja dhe duke vazhduar restaurimin e ikonostasit.

Jemi shumë krenarë për atë që bëjmë jo thjesht për fondet që japim por sepse punonjësit tanë angazhohen gjithashtu. Është e rëndësishme për ta që të jenë pjesë e këtyre aktiviteteve."

LARGIMI YNË

Ditës tonë të gjatë i erdhi fundi. Pas disa fotografish në grup, ne u kthëm në rrugën tonë për në Sofje. Gjatë rrugës nuk mund të mendonim se përshtypja jonë e parë u pasqyrua tek çdo njeri që takuam. Miniera Chelopech nuk nxjerr thjesht minerale të çmueshme, ata po kultivojnë krenarinë dhe qëndrueshmërinë.

Dëshirojmë të falenderojmë çdo njeri që takuam gjatë vizitës tonë në Chelopech dhe në Minierën e Chelopech. Kudo që shkuam u pritëm ngrohtësisht, miqësisht. Dëshirojmë gjithashtu t'i shprehim falënderimin tonë mikpritësve Radostina Ganeva dhe Petia Yoncheva nga tregtari Cat Eltrak Bullgari si dhe përkthyesve tanë Ivan Tortorochev dhe Gergana Todorova, e cila është edhe menaxherja e Marrëdhënieve me Publikun për Minierën Chelopech. ■



Irena Stambolieva, Drejtorjen e Sigurisë, Mjedisin dhe Marrëdhënien me Komunitetin për Minierën Chelopech.

"Sigurimi i qëndrueshmërisë së kësaj zone është shumë i rëndësishëm për ne."
Irena Stambolieva



LANDFILLI PIHOURC

Eneria France krijoi një mjedis të mbyllur tre metra të gjerë për kompletet e gjeneratorëve me një dalje përpara për ta bërë G3512 të shkëmbyeshëm me G3516.

NJË VIZION I BREZAVE TË SË ARDHMES KONVERTIMI I MBETJEVE NË ENERGJI

Ne të gjithë e dimë se gazetat mund të kthehen përsëri në jetë si kuti, ose se shishet e qelqit mund të mishërohen në banakë për kuzhinën. Por çfarë ndodh me miliona ton mbeturinash organike që përfundojnë në landfille? Ku shkon ai? Pra, me ndihmën e Caterpillar® dhe pajisjeve të specializuara të Cat®, ai kthehet në elektricitet dhe shkon si energji në mijëra shtëpi dhe biznese.

Krijimi i elektricitetit nga plehrat quhet mbetje-në-energji (WTE) ose energji-nga-mbetjet (EFW), dhe procesi, duke përdorur metanin, është relativisht një proces i thjeshtë. Ndërsa mbetjet organike dekompozohen, ato emetojnë gaz metani. Ky gaz metani kapet nga një sërë pusesh të shpuar në landfill dhe tërhiqet në një impiant grumbullimi ku ai filtrohet. Pastaj, gazi pompohet në motora me djegie, të cilët u japin energji gjeneratorëve që prodhojnë elektricitet.

Me një zhdërvjelltësi, zgjerueshmëri dhe efektivitet në kosto të pashoqe, kompletet e gjeneratorëve Cat e kthejnë gazin e metanit në 1,500 MW të energjisë elektrike ekonomike të gjithë globin. Kjo është e mjaftueshme që të furnizojë me energji 1,000,000 shtëpi.

PAJISJA CAT GJENERON ELEKTRICITET DHE QËNDRUESHMËRI

Caterpillar vazhdimisht bën kërkime, zhvillon dhe livron produkte që janë të projektuar në mënyrë specifike për të operuar duke përdorur gazin e landfilleve. Si pjesë e eficientësonë dhe qëllimeve mjedisore, ne jemi krenarë që të sigurojmë pajisje që prodhojnë energji miqësore për mjedisin në mënyrë eficiente duke ndihmuar reduktimin e gazeve të serave.

Aftësia e pajisjeve Cat për të kryer atë lloj performace dhe besueshmërie kompensohet edhe për klientët gjithashtu. Zgjatja e jetës së pajisjeve dhe intervalet e mirëmbajtjes ndihmojnë për të ulur kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes. Dhe, Caterpillar ofron module që kanë energji të kontejnierzuar që vihen menjëherë në punë të cilët rivendosen për të pasuar burimet e karburantit në vende të tjera. Aftësia e Caterpillar për të siguruar pajisje të përshtatura me performancë të lartë do të thotë se ju mund t'i besoni Caterpillar si ekspert kur vjen fjala për transformimin e mbeturinave në energji.





TRE STUDIME RASTI, TRE HISTORI SUKSESI



LANDFILLI BIFFA POPLARS

Biffa Poplars pritet që të prodhojë metan për 20 deri në 25 vjet.

Konvertimi i 3,000 metra kub në orë të gazit të landfillit, pesë kompletet e gjeneratorëve punojnë 24/7 dhe prodhojnë 6 MW të energjisë elektrike në 70 deri në 80 për qind të kapacitetit të ngarkesës.

LANDFILLI BIFFA POPLARS

Sot, kthimi i gazit të landfillit në elektricitet nuk është i pazakonshëm siç ishte më parë. Landfilli Biffa Poplars në Cannock, Mbretëria e Bashkuar (20 kilometra në veri të Birminghamit) vendosën që të bëjnë të tyre duke instaluar pesë komplete gjeneratorësh Cat me paketa karburanti energjie të ulët.

Tregtari i Cat Finning në Mbretërinë e Bashkuar ishte shumë i kënaqur që ta merrte përsipër sfidën. Fillimisht, tre komplete gjeneratorësh Cat G3516LE u instaluan. Secili mund të prodhojë në mënyrë të vazhduar 1,100 kW energji. Dy vjet më vonë, dy komplete gjeneratorësh Cat G3520C u vunë në punë, dhe secili prodhonte 1,950 kW energji. Cat G3520C me motor me 20-cilindra sigurojnë madje nivele më të larta të efencës sesa paraardhësit e tyre, me një përqindje konvertimi në energjinë elektrike që i kalon 40 për qind. Veç gjenerimit të elektricitetit, rikuperimi i nxehtësisë ishte një përfitim tjetër shtesë.

Tani që të pestë kompletet e gjeneratorëve janë në punë, ata mund të marrin 3,000 metra kub landfilli në çdo orë, duke e transformuar atë në 6 MW elektricitet dhe ja shesin atë rrjetit kombëtar të Mbretërisë së Bashkuar. Është një praktikë më e qëndrueshme sesa largimi i metanit duke e djegur.

Kompletet e gjeneratorëve Cat në Landfillin Biffa Poplars punojnë 8,000 orë në vit dhe monitorohen në njëzetë e katër orë. Por, ndoshta është më e përshtatshme të themi se janë 8,000 orë eficente në vit. Kjo ndodh sepse kompletet e gjeneratorëve operojnë në mënyrë eficente edhe kur përdoret gaz i landfillit me përmbajtje metani të ndryshueshme. Kantieri i Biffa Poplars vepron me një mesatare prej 50 për qind metan.

LANDFILLI PIHOURC

I njohur zyrtarisht si një landfill që përmban mbetje Jo-Toksike, Landfilli Pihourc është një fasilitet prej 70-hektarësh që ndodhet 90 kilometra nga Toulouse.

Sindikata Ndërkomunitare për Shumë Qëllime (SIVOM) përgjigjet për mbledhjen, ndarjen dhe trajtimin e më shumë se 85,000 metra ton mbetjesh të ngurta shtëpiake të prodhuara çdo vit nga 463 komunitete (35,000 njerëz) të cilëve u shërben landfilli.

Sigurisht, jo të gjitha mbetjet bëhen mbetje. SIVOM praktikisht gjeneron 50 për qind të të ardhurave të saj vjetore prej 19 milionë € duke krijuar elektricitet nga gaz i metanit.

Kompleti i gjeneratorëve sipas zgjedhjes që e konvertojnë gazin në elektricitet janë Cat G3516, i aftë për të prodhuar

“Ne gëzojmë një frymë të vërtetë pune në ekip me Eneria France, ashtu sikurse bashkojmë forcat për t'i shërbyer të mirës publike.”

Laurence D'Anterrosches, shefi i Departamentit të Mbetjeve Shtëpiake SIVOM

950 kW dhe G3512, i cili mund të krijojë 650 kW. Së bashku, ata prodhojnë një energji të jashtëzakonshme prej 1,600 kW dhe fasiliteti mund të prodhojë më tepër se 12,800 MWh elektricitet në kapacitetin e tij të plotë.

Tregtari i Cat Eneria France mundi pesë propozimet e konkurruesve të tjerë dhe fitoi projektin për të instaluar dy komplete gjeneratorësh. Laurence D'Anterrosches, shefi i Departamentit të Mbetjeve Shtëpiake SIVOM's thotë, “Ne zgjedhëm zgjidhjen e Eneria France si më i miri nga gjashtë propozimet e marra vetëm pas gjashtë muajsh negociata. Arsye kryesore për këtë zgjedhje ishin kapja nga ana e Eneria France e nevojave tona, garancitë solide teknike që ato



ofruan dhe aftësia e tyre për të dalë me zgjidhje teknike dhe tregtare të cilat ishin drejt në objektiv.”

Rezultatet flasin vetë. Ndërsa SIVOM kërkoi, për shembull, Eneria France në mënyrë substanciale rinovoi kantierin e prodhimit në vitin 2008. Qëllimi ishte të optimizohej furnizimi me gaz për të dy kompletet e gjeneratorëve, në vend që të digjej duke përmirësuar eficientësinë e konvertimit të metanit me fryrje më të fuqishme. Sot, përfitimi ekonomik është i madh. Mbledhja e metanit është më e qëndrueshme, dhe si rezultat, kompletet e gjeneratorëve çdo vit arrijnë 98 për qind kohë pune.

LANDFILLI I RRUGËS DARGAN

Parku Giant është një park publik novator prej 220 akra në Belfast, kryeqyteti i Irlandës së Veriut, por jo për shkak të fushave të sportit që ka, një rezerve natyrale, një fasiliteti arsimor dhe hapësirës për festime. Parku është novator sepse ndërsa vizitorët shijojnë barin e blertë të parkut, banorët e Belfastit përdorin elektricitetin e blertë që prodhon parku.

Kjo vjen sepse Parku Giant ndërtohet në landfillin tashmë të mbyllur të Rrugës. Kur Këshilli i Qytetit të Belfastit identifikoi landfillin e mëparshëm si një mundësi për të krijuar një park të ri, ata gjithashtu panë mundësinë për të përdorur gazin e metanit, i cili dilte nga mbeturinat e dekompozuar, për të prodhuar energjinë elektrike të blertë që mund të eksportohej në rrjetin vendor.

Për të kthyer ato mbetje të dekompozuar në energji të blertë, Këshilli i Qytetit kontraktoi Renewable Power Systems, Ltd. (RPS). RPS është udhëheqësi botëror në krijimin e energjisë së rinovueshme dhe të qëndrueshme. Detyra e tyre ishte e thjeshtë: kapja e gazit të metanit të landfillit dhe përdorimi i tij si një burim energjie miqësor me mjedisin që përndryshe do të ishte kthyer në mbetje në një farë mënyre.

Për të gjetur pajisjet që nevojiteshin për të kthyer metanin në mënyrë eficiente dhe efektive në energji elektrike, RPS ju drejtua tregtarit të Cat në Mbretërinë e Bashkuar Finning (UK) Ltd. Finning ka një përvojë dhe ekspertizë të gjerë në këtë fushë dhe mund të furnizojë, instalojë dhe të mirëmbajë kompletet e specializuara dhe me detyra të rënda të gjeneratorëve, pajisjet ndihmëse dhe aftësitë monitoruese nga larg që nevojiten.

Çdo gjenerator që punon me metan operohet nëpërmjet një sistemi kontrolli sinkronizimi që mbështetet në dysheme. Sistemi mund të sinkronizojë me rrjetin vendor të energjisë në mënyrë manuale ose automatike. Ai gjithashtu mund të monitorojë, kontrollojë dhe të mbrojë kompletet e gjeneratorëve Cat nëpërmjet Ndërfaqes së Makinës Njerëzore, ose në kantier ose nga larg. Dhe, për shkak se gazi i landfillit ka përmbajtje metani më të ulët se sa gazi natyral, Finning furnizoi gjeneratorë specifikë të projektuar në mënyrë speciale dhe të pajisur për të akomoduar Vlerën më të Ulët të Nxehtësisë të karburantit dhe për t’ju përgjigjur ndryshimeve në cilësinë e karburantit.

Yves Bornet, inxhinier i projektit të Caterpillar SARL thotë, “Kompleti i gjeneratorëve Cat G3516A ka një reputacion të shkëlqyer për performancën dhe besueshmërinë. Energjia mund të gjenerohet në mënyrë të vazhdueshme, 24/7, (24 orë në 7 ditë) duke përdorur gazin e landfillit të pasur me metan për të krijuar përfitime të mëdha mjedisore dhe ekonomike për Këshillin e Qytetit të Belfastit.”

Landfilli i mëparshëm i Rrugës Dargan do të gjenerojë elektricitet të blertë nga gazi i metanit për deri në 20 vjet dhe do të gjenerojë deri në pesë milionë vat të energjisë së blertë për rrjetin vendor për të furnizuar me energji rreth 6,000 shtëpi. ■



LANDFILLI I RRUGËS DARGAN

Çdo komplet gjeneratorësh mund të prodhojë 1,150 kW. Kur kombinohet, rezultati mund të jetë deri në masën 5.6 MW i energjisë të vazhduar që mund të eksportohet në rrjetin vendor.

Motori me 16-cilindra në çdo komplet gjeneratorësh të landfillit G3516A japin 37.9 për qind të eficientësisë së motorit me ngarkesë të plotë.



TË FLASIM PËR TË ARDHMEN E SHË



Ekspertët e monitorimit të gjendjes analizojnë volumet e të dhënave çdo ditë për të ndihmuar që pajisja e klientit të punojë pa probleme.

Parashikimi i nevojave të klientit është i vështirë në çdo biznes dhe kur vjen puna tek ndryshoret e skajshme të industrisë së pajisjeve të rënda, azhurnimi me nevojat e mirëmbajtjes dhe riparimit për një flotë shumë punëtore, të makinave të verdha gjigante mund të jetë një detyrë e papërballueshme.

Por çfarë ndodh në qoftë se pajisjet Cat mund të bisedojnë me kompjuterat? Në qoftë se sateliti i drejtpërdrejtë dhe GPS ushqen menjëherë shëndetin e makinës me rele? Dhe shkarkimet e pasura me informacion merren direkt nga sistemet që operojnë pajisjen?

Është pothuajse si një skemë nga ata filmat Transformues – pa pasur të gjithë shkatërrimin dhe kaosin. Megjithatë nuk janë filma fantastiko - shkencor. Ai quhet Monitorimi i Gjendjes. Dhe ndërsa termi nuk është i ri, Caterpillar është i pari që e prezanton këtë lloj mbështetjeje për klientin në industri.

PAJISJA CAT ËSHTË KAQ E PARASHIKUESHME

Ideja pas Monitorimit të Gjendjes është që tu japë klientëve Cat një paralajmërim për defektet ose prishjet potenciale. Por si e bën të mundur Caterpillar parashikimin e të ardhmes? E gjitha kjo lidhet me Menaxhimin e Pajisjes (EM).

Të zhvilluar nga Caterpillar, ka tre elemente thelbësorë të EM; Monitorimi i Gjendjes, Shëndeti i Pajisjes dhe Performanca e Flotës.

Komponenti i Monitorimit të Gjendjes të EM konsiston në grumbullimin dhe monitorimin e mijëra informacioneve nga një mori burimesh, duke përfshirë inspektimet, mostrat fluide, të dhënat elektronike, historia e makinës,

gjurmimi i komponentit dhe studimet e vendit. Të dhënat pastaj analizohen për tu dhënë klientëve një kuptim të thellë të shëndetit të pajisjes dhe performancës së flotës. Në këtë mënyrë ata mund të kujdesen për problemet përpara se ato të ndodhin.


NË BOTËN E MONITORIMIT TË GJENDJES, E ARDHMJAJA ËSHTË KËTU

Tregtari Cat Finning tashmë e ka çuar Monitorimin e Gjendjes në nivelin tjetër. Ata e quajnë atë "Finsight." Dhe ky është emri i përshtatshëm për konceptin që përmban ky mjet revolucionar i shërbimit të klientit.

Kjo vjen ngaqë tek Finning, Monitorimin i Gjendjes është diçka më tepër sesa thjesht kujdesi ndaj pajisjes së klientëve. Nomenklatura e zgjuar komunikon faktin që njerëzit pas Finsight janë një grup i trajnuar shumë i dedikuar për të gërmuar më thellë dhe për të analizuar informacionet. Përkushtimi i vazhdueshëm do të thotë që klientët marrin më shumë se sa faktet dhe shifrat për flotat e tyre, por edhe që depërtimi prej eksperti në mënyrën se si pajisja performon dhe çfarë mund të bëhet për të përmirësuar eficientësinë.


"Më parë na duhej që të shikonim në disa vende për të grumbulluar informacionin dhe historinë që nevojitej për të vlerësuar gjendjen e makinës. Tani, i gjithë ky informacion është në një vend. Është një mjet i shërbimit të klientit që është para kohës së vet dhe një avantazh shumë i madh për klientët tanë"- thotë Derek Batt, Menaxher i Shërbimit Finning (Juglindja).


Ekipi prej shtatë anëtarësh i vendosur në Staffordshire, fokusohet në industri të tilla si ndërtimi, minierat, mbetjet dhe riciklimi. Ata përdorin teknologji të kohës së fundit nga një dhomë e epokës hapësinore e vijuar me monitorë me ekran të sheshtë për të gjurmuar,

 = Shkaqet

 = Veprimet e rekomanduara


SISTEMI I FRENIMIT: Presioni i Ajrit të Traktorit i Ulët 

MOTORI: Shpejtësia e tepërt 

SISTEM ELEKTRIK: Voltazhi i baterisë tepër i lartë 

SHËNDËTIT TË PAJISJEVE, SOT

VENDNDODHJA:
CANNOCK
MBRETËRIA E
BASHKUAR



përpunuar dhe analizuar një mori informacionesh. Telemetria e pajisjeve monitorohet në mënyrë konstante. Kontrollohen faktorët mjedisorë që mund të ndikojnë në performancën e makinës. Lëngjet hidraulike, vajrat e motorit dhe ftohësit ekzaminohen. Dhe, shqyrtohen të dhënat nga historia e inspektimeve të automjetit.

REZULTATE TË MATSHME, PËRFITIME TË PAMATSHME TË KLIENTIT
Aftësia për të parashikuar dhe identifikuar problemet potenciale përpara se ato të bëhen më të rënda është një avantazh i konsiderueshëm. Ekspertët teknikë, gjithmonë gati, kanë akses ndaj një game të gjerë të informacionit mbështetës për të identifikuar zgjidhjet më të mira të mundshme shpejt dhe me kosto efektive.

“Kjo është një iniciativë e madhe që na dallon ne qartë nga konkurrenca.”

Iain Carpenter, Shefi i Operacioneve të Finning, Zhvillimi Strategjik

Falë kësaj qasjeje holistike, klientët mund të marrin vendime më të informuara, në kohë dhe të sakta për shëndetin dhe performancën e pajisjes së tyre. Mund të parandalohet koha pa punë e paprogramuar. Jeta e servisit mund të zgjatet. Kostot e operimit dhe riparimit mund të ulen. Dhe efica dencia dhe produktiviteti mund të rriten.

Veç kësaj, klientët të cilët blejnë ose marrin me qira pajisjen Cat kanë risigurim duke e ditur që po marrin mbështetje të përditshme shumë kohë pas shitjes fillestare.

James Ashbrook, Drejtor i Përgjithshëm i J.K. Ashbrook, Ltd. bie dakord se, “Ne jemi të sigurt që Finsight do të jetë me përfitim për biznesin tonë për faktin se ekipi do të ruajë dhe monitorojë makinat tona dhe do të na ndihmojë për të kuptuar më mirë informacionin që ne marrim. E gjitha kjo do të thotë që ne mund t’i heqim riparuesit dhe të bëjmë mirëmbajtje parandaluese në vend të pasjes së kohës pa punë dhe të defekteve.”

TEKNOLOGJIA DHE NJERËZIT PUNOJNË SËBASHKU

Megjithatë, ka akoma më tepër për Monitorimin e Gjendjes se sa kontrollet e shëndetit të pajisjes. Përgatiten raporte tre mujore të detajuar në mënyrë që klientët mund të shikojnë informacionin kyç i cili do t’i ndihmojë që t’i mbajnë pajisjet në punë në performancën më të lartë.

Elementi njerëzor gjithashtu është jetik. Inspektimet personale, vizuale nga inxhinierët e terrenit të Finning janë dhe gjithmonë do të jenë një pjesë e domosdoshme e vlerësimit të pajisjes Cat.

Nëse hetohen alarmet, analizohen kodet e paralajmërimit ose bëhet një inspektim personal i thellë i pajisjes, Monitorimi i Gjendjes përmirëson besueshmërinë e pajisjes dhe i jep klientëve një qetësi mendore duke e ditur se investimi i tyre mbështetet mirë pas shitjes. ■

» Gjeni më tepër për mirëmbajtjen dhe servilin tek:
www.uk.cat.com/parts-service



SISTEMI HIDRAULIK: Niveli i Vajit Hidraulik i Ulët **X**

KOVA: Këshilla për çarjen OK **✓**

- LINKU I PRODUKTIT
- MOSTRA SOS
- INSPEKTIMI I PAJISJES
- HISTORIA E MAKINËS
- VLERËSIMI I VENDIT

KËSHILLA OPERATORIT NGA EMMANUEL "SKINNY" CHATELAIN

AFTËSITË E MPREHTA JAPIN EFICENCË DHE KURSIME

Takoni Emmanuel Chatelain,
Demonstruesi Kryesor në Qendrën
e Demonstrimit dhe Mësimin
në Malaga, Spanjë. Ai dhe ekipi
i tij prej shtatë anëtarësh i japin
stafit të tregtarëve, operatorëve
dhe mbështetjes së produktit trajnim
të thelluar që fokusohet në teknikat e
operatorit dhe ndërtimin e vendit të punës.

Qëllimi i mësimin të këtyre praktikave më
të mira është i tillë që ato mund tu kalohen
tregtarëve dhe klientëve. Secili pastaj mund t'i
marrë ato njohuri dhe t'i ngrejë operacionet
e tij në nivelet më të larta të produktivitetit
dhe efikasitetit të karburantit duke ulur
emetimet CO dhe impaktet e tjera mjedisore
duke përfshirë kostot e e_2 dhe impaktet e
tjera mjedisore duke përfshirë kostot e
pronësisë dhe të operimit. Përmirësimet
e efikasitetit të karburantit nga 10 deri në
20 për qind janë të mundshme në tonët
që lëvizin për litër karburant të përdorur.*
Dhe disa rezultate të klientit tregojnë
kursime të karburantit deri në 30 për qind.

EMMANUEL CHATELAIN, AKA 'SKINNY'

e mori nofkën e tij pasi shokët
e ekipit të tij të demonstrimit
e krahasuan trupin e tij të
hollë me atë të një kolegu
më të shëndoshë.

NGARKIMI DHE TRANSPORTI

Është shumë e rëndësishme që të jetë lartësia
e kalimit e përshtatshme dhe hapësira e
manovrimit. Kur ngarkoni një kamion me një
ngarkues me rrota ose me ekskavator, ju doni që
pajisjet të plotësojnë njëra-tjetrën. Duke pasur dy
makina që punojnë mirë së bashku, kjo redukton
kohën që duhet për të ngarkuar dhe transportuar
materialet. Veç kësaj, kjo eviton mbingarkesën
ose nën-ngarkesën e punës të çdo makine.

Për shembull, përdorimi i ngarkuesit me rrota 966
për të ngarkuar një kamion 771 është konfiguracion
i gabuar. 966 nuk ka arritjen e mjaftueshme që ta
ngarkojë me efikasitet kovën e fundit kur 771 është
afër kapacitetit, duke e bërë të vështirë arritjen e
shpërndarjes së mirë të ngarkesës. Operatori 966
do të shpenzojë kohë dhe karburant shtesë për të



shpërndarë ngarkesën përpara se të jetë në gjendje që
të boshatis plotësisht kovën e tij. Një Lartësi më e Mirë
arrihet nga ngarkuesi me rrota vinçi i lartë 980 me 771.

TEKNIKAT E NGARKIMIT: PARANDALIMI I RROTULLIMIT TË RROTËS

Në vendet e punës shpesh ne shikojmë operatorët e
ngarkuesve me rrota që rrotullojnë rrotat më tepër seç
duhet kur ngarkojnë kovën. Kjo ndodh sepse ata nuk
përdorin teknikën e duhur. Kur futet në përgjatë operatori
duhet ta ngrejë kovën lehtë. Ajo që ndodh, është se
ngarkesa e asaj që ngrihet krijon presion apo forcë
për poshtë tek gommat dhe krijon tërheqje më të mirë.
Pastaj vazhdoni ta ngrini ta mblidhni në të njëjtën
kohë. Kjo teknikë do të reduktojë konsumimin e kovës,
mjeteve që angazhohen në tokë, gomave dhe do të
krijojnë faktorë më të mirë për mbushjen e kovës.

POZICIONI OPTIMAL I KAMIONIT: KËNDI 45-GRADË

Kur ngarkojmë një kamion me mbeturina nga një
përgjatë duke përdorur ngarkuesin me rrota, pozicioni i
të dy makinave mund të krijojë një dallim të madh
në prodhim. Së pari, ngarkuesi me rrota duhet të
ketë një kovë të plotë, të ngritur dhe të jetë në

*Bazuar në një llogaritje teorike
nga të dhënat e matura dhe
të regjistruara në kantier.

këndin 45- gradë me pirlgun. Pastaj, shoferi i kamionit duhet ta kthejë dhe ta vendosë shinën e trupit nën kapësen e kovës. Është detyra e personit që operon ngarkuesin me rrota që ta drejtojë kamionin e mbeturinave në pozicionin me këtë kënd.

Në mënyrë ideale ngarkuesi me rrota nuk duhet t'i kalojë 1.5 deri në 2 rrotullime të gomës. E njohur si modeli V, ky është konfiguracioni më i mirë i ngarkimit. Ai redukton kohën e ciklit, konsumimin e makinave dhe kostot e operimit. Koha ideale e ngarkimit është rreth dy minuta në katër ose pesë kova.

DISTANCA E NGARKIMIT

Ne thamë se një distancë udhëtimi prej 1.5 deri në 2 rrotullime të gomës është ideale. Pse është kjo kaq v

të lehtë. Ekskavatori duhet gjithashtu të pozicionohet saktë në vendin e ngarkimit duke ecur përfundimisht me pamje nga zona e ngarkimit (në varësi të konfiguracionit të ngarkimit) për të zvogëluar shansin që kjo pjesë e rëndësishme të dëmtohet nga mbeturinat.

TRAKTORËT E TIPIT ME ZINXHIRË: SHTYTJA NË DISHEZË

Kur vjen fjala për të shtyrë Cat prodhon disa makina dhe mjete të fuqishme për ta bërë punën më të lehtë. Por ekziston një mjet që mund ta përdorni i cili nuk vjen si standard apo si opsion në çdo buldozer Cat dhe ky është graviteti. Duke përdorur gravitetin për të shtyrë materialin, dhe buldozerin, në dishezë, kjo është një mënyrë shumë e mirë për të rritur produktivitetin. Por, çdo vend pune ka sfida të tij dhe të shtysh materiale në dishezë mund të mos jetë një opsion. Por, kur është,



1 KAMION = 5 KOVA TË NGARKUESIT X 10 METRA = 50 METRA
 1 ORË = 20 KAMIONË TË NGARKUAR
 50 METRA X 20 KAMIONË = 1 KM QË PËRSHKOHET NË ÇDO ORË
 1 DITË = 8 ORË X 1 KM = 8 KM NË DITË
 1 MUAJ = 26 DITË X 8 KM = 208 KM
 1 VIT = 12 X 208 KM = 2,496 KM

Ky është vetëm një skenar për shembull që tregon qartë se si edhe thjesht pesë metra mund tu shtohen kostove të shumta.

VENDNDODHJA:
 MALAGA
 SPANJË



rëndësishme? Thjesht hidhini një vështrim mostrës këtu, për të parë se çfarë dallimi është në qoftë se kamioni pozicionohet në 4 metra shtesë nga ngarkuesi, duke e bërë ngarkuesin që të udhëtojë 10 metra më tepër për çdo cikël. (Referojuni llogaritjeve në imazh për të parë se çfarë dallimi mund të krijojë distanca e ngarkimit.)

TEKNIKAT E NGARKIMIT ME EKSKAVATOR:

LARTËSIA E VENDIT TË NGARKIMIT

Një ndryshore e rëndësishme e vendit të punës është lartësia e vendit të ngarkimit. Mund të mos duket e rëndësishme, por kjo mund të luajë një rol të madh në efikasitetin e punës në kantier – veçanërisht kur është fjala për ekskavatorët. Kur vendi është shumë i lartë, ekskavatori nuk do të arrijë në mënyrë të mjaftueshme të pastrojë dyshemenë dhe të shpërndajë materialin në pjesën e përparme të kamionit. Kur vendi është tepër i ulët, është e vështirë që të kemi një faktor të mbushjes optimale të kovës dhe kjo redukton vizibilitetin në trupin e kamionit.

Lartësia e përsosur e vendit do të ishte që ai të kishte të njëjtën lartësi me gjatësinë e krahut të ekskavatorit dhe/ose lartësinë e trupit të kamionit. Në këtë mënyrë, ekskavatori mund të arrijë dyshemenë për ta mbajtur të pastër zonën e ngarkimit, duke u lejuar kamionëve akses

ju mund të fitoni 2 për qind në prodhim për çdo 1 për qind pjerrësi e favorshme deri në 20 për qind.

Një teknikë tjetër e dobishme është ajo që ne e quajmë shtyrja me çarje. Me këtë teknikë, operatori krijon një çarje (një transhe), duke filluar nga përpara dhe duke punuar drejt pjesës së pasme të prerjes. Në këtë mënyrë, krijohet një mur në secilën anë të thikës e cila do të përmbajë materialin përpara thikës.

Në numrin tjetër të Revistës Cat, këshillat e Operatorit fokusohen në sigurinë e vendit të punës. ■

'SKINNY' DUKE SHPJEGUAR POZICIONIN V

Shembulli i ekipit se si thjesht pesë metra mund t'ju shtohen mungesës së pabesueshme të efikasitetit gjë e cila realisht na bën që të hapim sytë.

PRODUKTIVITETI I KANTIERIT TË PUNËS RRITET GJITHNJË

Makinat Cat® të njohura për fuqinë e tyre prej bishë, besueshmërinë dhe avancimet teknologjike. Tani, Caterpillar® mund të shtojnë një komponent tjetër në listën e tyre të gjatë të tyre të novacioneve – gomat. Më konkretisht, gjenerata e re e gomave solide "me dalje".



Gomat Flexport janë të përsosura për aplikime të shumëllojshme dhe mund të përdoren në një numër sipërfaqesh.

Fjala "solid" mund të jetë një emërtim i gabuar, sidoqoftë. Gomat Flexport™ janë ndërtuar për të qenë hallka munguese midis gomave me ajër dhe besueshmërisë së gomave solide duke përfshirë disa avantazhe që i veçon ato nga konkurrenca.

Avantazhi i parë është projektimi unik i mureve anësore të Flexport. Ndryshe nga gomat solide me porta anësore të rumbullakëta, Caterpillar projekttoi gomat Flexport me porta eliptike. Kur vendosen nën ngarkesë, portat eliptike kompresohen dhe bëhen të rumbullakëta, duke reduktuar pikat e stresit, duke përmirësuar ecjen dhe duke rritur jetëgjatësinë e tyre. Prova e shpimit, një projektim mjaft i hollë, mund të trajtojë të gjitha llojet e sipërfaqeve pa pasur nevojë për të ndaluar punën për të rregulluar gomat.

Pasi mësoi se Kettanah Construction Plant Manager Jihad Mohana kishte dikë që i kushtohej vetëm rregullimit të gomave të rëna të ngarkuesit me timon, Yazan Haddad, PSSR tek tregtari Cat Al-Bahar, i sugjeroi gomat Flexport. "Ne vuanim çdo ditë nga problemet e gomave dhe u dedikuar për të provuar një komplet gomash Flexport. Kur u instaluan, ne nuk u shqetësuam për to. Jeta mesatare e gomave pneumatike e gomave që ne përdornim ishte tre deri në katër muaj. Jeta mesatare e gomave Flexport është dy deri në tre vjet," tha Mohana. "Këto goma Flexport janë praktikisht 'para në bankë për ne.'"

NJË RACË E NDRYSHME E GOMËS SOLIDE

Caterpillar është i vetmi prodhues i pajisjeve të rënda që prodhon gomat e tij. I projektuar për ngarkuesit me rrota dhe ngarkuesit me timon, këto goma zëvendësuese me një pjesë janë të disponueshme në tre modele të ndryshme të luleve – Ndërtimi, të Lëmuara dhe për Fuoristrata (OTR). Secili projektim krijon drejtpeshimin e duhur për ecjen, besueshmërinë, kohëzgjatjen dhe stabilitetin e rritur që i bëjnë operatorët të ndjehen më të sigurt kur përdorin makinën me ngarkesa të rënda, dhe të pa barabarta.

Meqenëse ato thithin mjaft goditje që gomat standarde solide ua kalojnë operatorëve, gomat Flexport krijojnë një performancë më të rehatshme në ecje dhe tërheqje të përmirësuar. Si rezultat, shoferët lodhen më pak dhe mund të jenë më produktiv, duke rritur të ardhurat tuaja.

Z. Yousef Ghadban, Plant dhe Equipment Manager i Al Jaber dhe Makhlouf WLL, gjithashtu i provuan gomat Flexport. Pas vetëm pak muajsh, ai porositi komplete për pajisjet e tjera. "Bëra një krahasim të kostos për orë midis gomave Flexport dhe gomave normale pneumatike që ne përdornim. Konstatova se gomat Flexport i kalonin gomat pneumatike. Tani nuk kam më ankesa nga mbikëqyrësit e kantierëve në lidhje me shpimet," thotë Ghadban. "Ne thjesht i instalojmë ato dhe nuk shqetësohemi më për to."

Gomat Flexport kanë një lule që është deri në dy herë më e thellë se sa gomat pneumatike me përmasa të krahasueshme. Por thjesht shtimi i gomës nuk do të thotë me domosdo një jetë më e gjatë. Prandaj gomat Flexport bëhen duke përdorur vetëm 100 për qind gomë natyrale. Kjo do të thotë se ju merrni cilësinë më të lartë, me jetëgjatësinë më të madhe.

FRYHENI KOHËN TUJË TË PUNËS PA FRYRË GOMAT TUJAJ

Pajisja më e mirë, operatorët më të aftë dhe mirëmbajtja më e kujdesshme e makinës mund të jenë të padobishme në qoftë se një makinë nuk është në gjendje të operojë për shkak të ndërprerjes së punës nga defektet e gomave. Gomat Flexport të Cat prodhohen për të performuar në mënyrë më konsistente sesa gomat konkurruese dhe për të plotësuar ose tejkaluar jetën e servilit të alternativave të tjera të gomave solide – të gjitha këto në saj të angazhimit të legjendarit Caterpillar për tu dhënë klientëve mjetet që ju nevojiten për të bërë punët dhe disa elipse të krijuara me mjaft zgjuarsi.

I kërkoni tregtarit tuaj më tepër informacion për gomat Flexport ose për opsionin OE ose për zëvendësimin pas shitjes. ■



» Lexoni më tepër për gomat Flexport:
<http://parts.cat.com/parts/tires>

CAT MAGAZINE

ANKETIM I LEXUESVE – OPINIONI JUAJ KA RËNDËSI

Ndërsa po punojmë për të përmirësuar pajisjen Cat ne gjithashtu po punojmë për të rritur Revistën Cat dhe duam që ky publikim të jetë një mjet i vlefshëm për ju. Kështu, për të ndihmuar në formësimin e revistës sipas interesave tuaja ju lutemi a mund t'ï përgjigjeni disa pyetjeve si më poshtë. Kjo do të marrë vetëm disa minuta dhe **20 të anketuarit e parë do të marrin një kapele të re Cat.**

Zgjidhja është për ju:

1. Plotësoni në anketimin on-line në catmagazinesurvey.com
2. Skanoni anketimin dhe na e dërgoni me e-mail
info@teknogroup.com
3. Printoni dhe na e dërgoni me e-mail këtë pyetësor
Teknogroup Shqiperi SH.P.K.
Fshati Mucaj - Vore - Albania

PROFILI JUAJ

1. JU LUTEMI NA THONI DIÇKA MË TEPËR PËR JU

EMRI I SHOQËRISË: _____

EMRI, MBIEMRI: _____

VENDI: _____

EMAIL: _____

2. ÇFARË E PËRSHKRUAN MË MIRË PROFILIN DHE POZICIONIN TUAJ?

- Operatori i pronarit (ndërmarrje e vogël)
- Operatori
- Tekniku i servisit
- Menaxheri i flotës
- Dhënësi i zgjidhjes / Projektuesi
- Drejtori i Përgjithshëm / Blerësi

Në qoftë se nuk jeni pjesë e një sipërmarrjeje (klient i Caterpillar), ju lutemi shënoni tek "Jo relevante" më poshtë dhe shkoni direkt tek pyetja 5.

Jo relevante (ju lutemi specifikoni) Unë: _____

3. A KA SHOQËRIA JUAJ MAKINA CAT NË FLOTËN E SAJ?

- Po, makinat Cat përfaqësojnë më tepër se 50 për qind të flotës
- Po, makinat Cat përfaqësojnë më pak se 50 për qind të flotës
- Jo

4. ÇFARË DO TA PËRSHKRUANTE MË MIRË FUSHËN KRYESORE TË

BIZNESIT DHE TË AKTIVITETEVE TË SHOQËRISË TUAJ?

- Ndërtim në shkallë të vogël
- Makineri të rënda / Lëvizje e madhe dheu apo punime rruge
- Gurore dhe agregate
- Mbetje dhe aplikime industriale

- Shtrim rrugësh
- Miniera
- Marrje me qira / dhënie me qira e fabrikave
- Klientët e Sistemeve të Energjisë (energji elektrike, detare, nafta dhe gazi, etj.)
- Industri të tjera (Ju lutemi specifikojini)

VLERA E INFORMACIONIT

5. A I MERRNI ATO QË MËSONI PËR MAKINAT E REJA, MOTORËT, SERVISET APO TEKNOLOGJITË NË REVISTËN CAT DHE I NDANI ATO NJOHURI ME TREGTARIN TUAJ VENDOR CAT?

- Po
- Jo

6A. SA NJERËZ NË SHOQËRINË TUAJ E LEXOJNË NJË KOPJE TË REVISTËS CAT?

- Vetëm unë
- Unë dhe një person tjetër
- 3 deri 4 vetë
- 5 ose më tepër

6B. NË QOFTË SE NJERËZIT E TJERË E LEXOJNË KOPJEN TUAJ CILËT JANË ATA? (JANË TË MUNDSHME DISA ZGJEDHJE)

- Operatori i Pronarit (ndërmarrja e vogël)
- Operatori
- Tekniku i Servisit
- Menaxheri i Flotës
- Dhënësi i zgjidhjes / Projektuesi
- Drejtori i Përgjithshëm / Blerësi
- Të tjerë (Ju lutemi, i specifikoni)

7. A JENI TË KËNAQUR ME AQ NUMRA TË REVISTËS CAT QË BOTOHEN NË VIT?

- Po, 3 herë në vit është në rregull
- Jo, do të dëshiroja që Revista Cat të botohej më shpesh

8. KUR LEXONI NJË ARTIKULL NË REVISTËN CAT, A ËSHTË NË MËNYRË TIPIKE HERA E PARË QË JU DËGJONI PËR ATË HISTORI (PRODUKTE TË REJA, TEKNOLOGJI, PROJEKTE TË TJERA, ETJ.)?

- Po
- Jo, zakonisht unë i kam diskutuar të njëjtat tema me tregtarin tim vendor
- Jo, zakonisht i kam diskutuar të njëjtat tema me partnerë të tjerë biznesi (në biseda)
- Jo, unë zakonisht lexoj për historitë në internet (cat.com, faqja e internetit e tregtarit, rrethi i shtypit, etj.)

9. SI DO TA DONIT QË TU DËRGOHEJ REVISTA CAT?

- Revistë e shtypur
- Interaktive on-line PDF ose flipbook
- Revistë e shtypur ose revistë on-line

10. SI DO TA VLERËSONIT REVISTËN ON-LINE?

- E lehtë për tu lexuar dhe miqësore në përdorim
- Vlerë e shtuar që ofrohet nga linket ueb dhe videot
- I vështirë për tu lexuar teksti,
- Të vështira për tu parë fotografitë
- Nuk ka përdorim të linkeve ueb dhe të videove të fiksuara
- Nuk e lexoj asnjëherë revistën on-line

ARTIKUJT DHE TEMAT

11. A NDIKOJNË ARTIKUJT DHE HISTORITË E SUKSESIT QË MBULON REVISTA CAT NË VENDIMET TUAJA PËR BLERJE DHE RIBLERJE? (TË MUNDSHME DISA PËRZGJEDHJE)

Po, ato kanë një ndikim në vendimin për:

- blerjen e produkteve të reja produkteve të përdorura ose për marrjen me qira të pajisjeve.
- për blerjen e pajisjeve, zgjidhjet e drejtuesve (kontratat e mirëmbajtjes ose të servisit, Linkun e Produktit, etj.)
- për të blerë pjesë të vërteta Cat (bateri, komponentët e boshtit udhëzues dhe xhuntës së Hukut, etj.)
- për të blerë teknologji të avancuara për të përmirësuar produktivitetin (goma AccuGrade, Flexport tires, etj.)

Ose

- Jo, ato nuk ndikojnë në vendimet e mia për të blerë

12. DUKE PARË LLOJIN E ARTIKUJVE QË MBULON REVISTA CAT SOT, CILAT JANË ME INTERESIN MË TË MADH PËR JU? (JU LUTEMI SHËNOJENI)?

1 = Jo interesante

2 = Mesatare

3 = Interesante

Projektet vendorë, në terren dhe klientët

1 2 3

Projektet dhe klientët në vendet e tjera

1 2 3

Projektet në industri të ndryshme nga ajo të cilës i përkisni

1 2 3

Historitë e shkurtra në "Cat Shkurt"

1 2 3

Këshillat për operatorin ose mirëmbajtjen

1 2 3

Prezantimet e produktit të ri

1 2 3

Historitë e suksesit të servisit dhe mirëmbajtjes

1 2 3

Profilat e Caterpillar, tregtarit dhe klientit

(njerëzit, intervistat e thelluara)

1 2 3

13. ÇFARË TEMASH TË TJERA DO TË DËSHIRONIT T'I SHIKONIT TË MBULUARA NGA REVISTA CAT? (JANË TË MUNDURA DISA PËRZGJEDHJE)

- Teknologjitë e reja
- Progresi i qëndrueshmërisë
- Iniciativat e shitësit vendor
- Iniciativat e shoqërive (p.sh., ndërtimi i një fabrike të re nga Caterpillar)
- Prapa skenave në Caterpillar
- Të tjera (Ju lutemi specifikojeni)

14. A I LEXONI REVISTAT E BOTUARA NGA PRODHUES TË TJERË? NË QOFTË SE PO, CILËT PRODHUES?

- Volvo (Shpirti Volvo)
- Komatsu (Kohët Komatsu)
- Hitachi (Kontrolli i Tokës)
- JCB (Terreni)
- Të tjera (Ju lutemi specifikojeni)

- Jo, unë nuk lexoj revista nga prodhues të tjerë të pajisjeve të ndërtimit

15. ME PAK FJALË, SI DO TA PËRSHKRUANIT DHE CILËSONIT REVISTËN CAT?

FALEMINDERIT PËR KOHËN TUAJ. SHIKONI PËR REZULTATET NË REVISTËN CAT 1/2013.

ARRIJNË MË TEJ

GJITHË DITËN. ÇDO DITË



PREZANTIMI I SERIVE TË REJA TË CAT®

Brezi tjetër i ekskavatorëve hidraulik Cat® është projektuar që të arrijë më tej të vendosë — standarde të reja të industrisë për produktivitetin — gjithë ditën, çdo ditë.

- Kapaciteti i ngritjes dhe forca e gërmimit më e madhe çon në produktivitet më të lartë
- Sistemi hidraulik i përmirësuar për efikasitet më të mirë karburanti
- Përmirësimet në kabinë rritin komfortin e operatorit dhe produktivitetin
- Rigjenerimi automatik ndihmon për eliminimin e kohës pa punë

CAT, CATERPILLAR, logot e tyre përkatëse, "Caterpillar i Verdhë" dhe "Power Edge" veshje tregtare si dhe identiteti i shoqërisë dhe i produktit këtu janë marka tregtare të Caterpillar dhe nuk mund të përdoren pa leje.
© 2011 Caterpillar. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Teknoxgroup





©2011 Caterpillar, All Rights Reserved. CAT, CATERPILLAR, their respective logos, "Caterpillar Yellow" and the POWER EDGE trade dress, as well as corporate and product identity used herein, are trademarks of Caterpillar and may not be used without permission.



TEKNOXGROUP SHQIPERI SH.P.K.
Fshati Mucaj - Vore - Albania
Tel: +355 44504747
Fax: +355 44504750

